



**FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT**  
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

## **RAPORT I AKTIVITETIT VJETOR 2012**

**Janar 2013**

**SHKURTIME**

CEB	Banka e Këshillit të Europës
IDA	Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim
BB	Banka Botërore
DPUK	Drejtoria e Pergjithshme e Ujesjelles Kanalizimeve
EBRD	Banka Europiane per Rindërtim dhe Zhvillim
EIB	Banka Europiane e Investimeve
IDB	Banka Islamike e Investimeve
GoA	Qeveria Shqiptare
KGK	Komiteti i Granteve Konkurruese
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
MIS	Sistemi Menaxhimit të Informacionit
NQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NTA	Norway Trust Account
OFID	Fondi i OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar
PNMZM	Plani i Ndjekjes së Masave Zbutëse mbi Mjedisin
PZHL	Plani i Zhvillimit Lokal
CES	Consulting Engineers Salzgitte
RI	Roughton International
SIF	Fondi i Investimeve Sociale
FIDIC	Federata Ndërkombëtare e Konsulences Inxhinierike (International Federation of Consulting Engineers)
WBIF	Western Balkans Investment Framework

## Pasqyra e lëndës

1. PËRMBLEDHJE .....	4
2. RAPORTI I AKTIVITETIT .....	7
2.1 Programi “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore e Lokale në Shqipëri” .....	9
2.2 Programi “Punët në komunitet III” financuar nga CEB.....	16
2.3 Programi “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale” financuar nga KfW .....	18
2.4 Bashkëpunimi i FSHZH me Komitetin e Zhvillimit të Rajoneve në kuadër të Projekteve të Infrastrukturës Vendore.....	21
2.5 Ndriçimi i 9 kalave kryesore te Shqiperise në kuader te 100-vjetorit te Pavaresise .....	22
3. AKTIVITETI INSTITUCIONAL .....	23
3.1 Menaxhimi Financiar .....	23
3.2 Komunikimi dhe Informimi.....	29
3.3 Monitorimi dhe Vlerësimi.....	30
3.4 Auditimi i brendshëm .....	32
4. AKTIVITETE TE TJERA .....	33
4.1 Misione të Donatorëve .....	33
4.2 Ndërtimi i kapaciteteve të NjQV-ve .....	34
4.3 Përgatitje e projekteve për financim .....	36
ANEKSE .....	38
5.1 Informacion mbi nën-projektet e programit “Punët në komunitet III” Dhjetor 2012.....	39
5.2 Informacion mbi nën-projektet e programit “Rrugët Dytësore & Lokale”, financuar nga Banka Botërore & GoA (IDA) .....	42
5.3 Informacion mbi nën-projektet e programit “Rrugët Dytësore & Lokale”, financuar nga OFID.....	43
108 km.....	43
5.4 Informacion mbi nën-projektet e programit “Rrugët Dytësore & Lokale”, financuar nga CEB .....	44
5.6 Informacion mbi nën-projektet e programit “Rrugët Dytësore & Lokale”, financuar nga IDB .....	47
5.7 Informacion mbi nën-projektet e programit “Rrugët Dytësore & Lokale”, financuar nga EBRD, EIB,.....	48
5.8 Informacion mbi nën-projektet e programit “Rrugët Dytësore & Lokale”, financuar nga KfW, IPA 2009 .....	51
(Dhjetor 2012).....	51
5.9 Informacion mbi nën-projektet e programit “Furnizimi me Ujë i zonave Rurale”, financuar nga KfW (Dhjetor 2012).....	52
5.10 Realizimi i zerave te buxhetit per vitin 2012 (sipas Donatoreve).....	53
5.11 Shpenzimet sipas Donatorëve dhe Kategorive për vitin 2012 (në Euro).....	56
5.12 Rrugët Dytësore dhe Lokale të përfunduara deri më 31 Dhjetor 2012.....	57
5.13 Rrugët Dytësore dhe Lokale ne zbatim deri më 31 Dhjetor 2012 .....	82
5.14 Harta treguese e nenprojekteve te perfunduara dhe ne zbatim nga FSHZH më 31 Dhjetor 2012 .....	95

## 1. PËRMBLEDHJE

Fondi Shqiptar i Zhvillimit gjatë vitit 2012 është angazhuar intensivisht në përbushjen e misionit të tij për nxitjen e një zhvillimi ekonomik dhe social të qëndrueshëm, të balancuar dhe koheziv në nivel rajonal dhe lokal.

Volumi i investimeve, fondeve të levruara, numri i kontratave të reja dhe atyre të menaxhuara si edhe vlerësimet maksimale të marra nga donatorët dhe partnerët ndërkombëtare, e bëjnë vitin 2012 një ndër vitet më të sukseshme të këtij institucioni që nga krijimi i tij.

Sfidat e këtij viti, kanë rikonfirmuar profesionalizmin e FSHZH-së dhe kapacitetet e saj për të menaxhuar projekte shumëdimensionale, si dhe për të lëvruar në kohë dhe me cilësi produkte që përmirësojnë gjendjen ekonomike dhe sociale të shqiptarëve.

FSHZH tashme ka konsoliduar një fizionomi të qartë, ka një staf të specializuar dhe profesional, me kapacitete menaxhimi të forcuara dhe me një frymë ekipi pozitive. FSHZH vazhdon të mbetet një institucion lider në fushën e zhvillimit rajonal, duke qënë një pike referimi si për Qeverinë Shqiptare, por mbi të gjitha për qeveritë lokale, të cilat kanë krijuar një partneritet funksional me FSHZH-në.

Kjo fizionomi e FSHZH-së si edhe arritjet e saj gjatë vitit 2012 janë vënë në vëmendjen e publikut të gjerë duke shtuar interesin dhe mbështetjen publike ndaj aktivitetit dhe arritjeve të institucionit.

Gjatë vitit 2012 Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka mbështetur dhe asistuar me fonde investimi NjQV-të dhe komunitetet për rehabilitimin e infrastrukturës dhe përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet projekteve të infrastrukturës rrugore dytësore dhe lokale, projekteve të ujësjellës-kanalizimeve, projekteve komunitare etj. Programet e investimeve të menaxhuara për periudhën 2011-2012 janë: “Programi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”, “Programi Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale” dhe “Programi i Punëve në Komunitet III”.

Investimet në infrastrukturë edhe këtë vit kanë zënë peshën kryesore të aktivitetit institucional të FSHZH. Gjatë 2012, FSHZH është angazhuar në një total prej 237 nënprojektesh të infrastrukturës rurale, me një shpërndarje gjeografike gjithëpërfshirëse. Planifikimi i zhvillimit dhe ngritja e kapaciteteve në nivel rajonal dhe lokal është një tjetër komponent mjaft i rëndësishëm ku është fokusuar puna e institucionit.

Performanca shumë e lartë e treguar nga FSHZH është arritur falë profesionalizmit, përkushtimit dhe punës në ekip të stafit të saj dhe përballja me sfidat që janë shfaqur. Fleksibiliteti dhe shpejtësia e vendimmarrjes, standartet e vendosura në menaxhim, vlerat morale dhe profesionale, transparencja dhe komunikimi me publikun, serioziteti dhe profesionalizmi kanë qënë tiparet themelore të punës së institucionit gjatë vitit 2012.

FSHZH ka vazhduar të asistojë Komitetin e Zhvillimit të Rajoneve për vlerësimin teknik të projekteve të Infrastrukturës lokale, duke qënë një aset mjaft i vlefshëm për maksimalizimin e impaktit të investimeve që ky komitet përcakton.

Në kuadër të Programit “**Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale**”, ky vit shënoi financimin e gjithsej 107 segmenteve të rrugëve dytësore dhe lokale, me një gjatësi totale prej 974 km. Këtë vit kanë përfunduar punimet civile në 20 segmente rrugore, duke e çuar në 69 numrin total të rrugëve të rikonstruara në kuadër të këtij programi.

FSHZH si agjenci implementuese e këtij programi po vazhdon të kryejë me sukses rolin e saj në monitorimin, koordinimin dhe implementimin e shpejtë të këtij programi, duke garantuar realizimin me cilësi dhe përgjegjshmëri të të gjitha objektivave të zbatimit të programit.

Ecuria e financimit ka treguar progres dhe rezulton që deri në Dhjetor 2012 janë në proces zbatimi 368 Milionë USD. Kësaj shume pritet ti shtohen edhe financime të tjera të cilat janë në negociim me Agjencinë Japoneze për Zhvillim Ndërkombëtar (JICA), dhe Bankën e Këshillit të Europës për Zhvillim (CEB), e cila do të rifinancojë me një paketë të dytë financiare. Së bashku me këto financime programi parashikohet të tejkalojë ndjeshëm shumën prej 400 Milionë USD të vendosur si objektiv në fillim të tij.

**Programi “Punët në Komunitet III”**, ka përfunduar duke përbushur me sukses të gjitha objektivat e vendosura në fillim të tij. Muaji Prill 2012 shënoi dhe përfundimin e punimeve civile për objektin e fundit, duke çuar kështu në finalizimin me sukses të 45 nënprojekteve infrastrukturore të financuara. Komponenti i ngritjes së kapaciteteve lokale ka përfunduar me sukses duke siguruar mbështetje shumëplanëshe për komunitetet përfituese të këtij projekti. Projekti ka konsoliduar zhvillimin e qëndrueshëm të 16 komunave duke i pajisur ato me Plane Zhvillimi, si dhe duke i mbështetur këto plane me projekte të rëndësishme infrastrukturore. Një arritje e këtij projekti është edhe ngritja e kapaciteteve brenda FSHZH-se, të cilat janë një mjet i mire për të asistuar në mënyrë të vazhdueshme NJQV-të në ngritjen e kapaciteteve. Programi mund të thuhet se ka përbushur plotësisht objektivat e vendosura në fillim të zbatimit të tij.

**Programi “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale”**, është drejt përfundimit të punimeve infrastrukturore për 25 skema ujësjellësish. Gjatë kësaj periudhe kanë përfunduar punimet për 6 kontratat e para që përfaqësojnë 13 skema ujësjellësash në Qarqet Dibër, Kukës dhe Shkodër. Ecuria e projektit si në zbatimin e punimeve ashtu edhe në zbatimin e masave shoqëruese shfaqet e kënaqshme. Parashikohet që muaji Qershor 2013 të shënojë përfundimin e punimeve civile në të gjitha skemat e ujësjellësive të financuar dhe të fillojë faza e funksionimit dhe mirëmbajtjes së tyre. Menaxhimi profesional dhe zbatimi i kënaqshëm i këtij programi, ka rezultuar me përfitimin e një financimi të dytë nga ana e KfW-së për këtë program në vlerën prej 5 Milionë Euro.

Saktësia dhe standartizimi i projekteve teknike, zbatimi me cilësi i punimeve dhe përmirësimi i kushteve teknike të aplikuara, kanë qenë një nga prioritetet institucionale të cilit i është kushtuar një vëmendje e vecantë.

Menaxhimi financiar gjatë vitit 2012 ka garantuar ekuilibrat financiarë duke mbajtur aktivitetin ekonomik - financiar të organizuar brenda limiteve të lejuara të financimit. Gjithashtu vëmendje i është kushtuar administrimit dhe menaxhimit të fondeve me përgjegjshmëri dhe transparencë, si dhe monitorimit e mbikqyrjes së detajuar të fondeve sipas komponentëve përkatës: investime në infrastrukturë, administrim të brendshëm, asistencë teknike, etj. Gjatë këtijviti FSHZH ka arritur një realizim financiar në vlerën 76.75 Milione USD, ose në masën 94 %.

Gjatë këtij viti, veçanërisht në gjashtëmuorin e fundit, është realizuar me sukses një fushatë për informimin publik nëpërmjet mediave vizive dhe atyre të shkruara, nëpërmjet së cilës është siguruar dhe njohja e gjerë e publikut me rezultatet e punës së FSHZH-së si edhe aktivitetet në vijim.

Performanca shumë e lartë e treguar nga FSHZH është arritur falë profesionalizmit, përkushtimit dhe punës në ekip të stafit të saj dhe përballja me sfidat që janë shfaqur. Fleksibiliteti dhe shpejtësia e vendimmarrjes, standartet e vendosura në menaxhim, vlerat morale dhe profesionale, transparencja dhe komunikimi me publikun, serioziteti dhe profesionalizmi kanë qenë tiparet themelore të punës së institucionit.

## 2. RAPORTI I AKTIVITETIT

Investimet në infrastrukturë zënë peshën kryesore të aktivitetit institucional të FSHZH. Gjatë vitit 2012, FSHZH është angazhuar në një total prej 247 nën-projektsh të infrastrukturës rurale, me një shpërndarje gjeografike gjithëpërfshirëse.

Pjesën kryesore të këtyre investimeve e zënë rrugët dytësore & lokale, ujësjellësat dhe kanalizimet, projektet e ndërtimit dhe rehabilitimit të objekteve turistike, etj.

Deri në fund të muajit Dhjetor 2012, janë përfunduar 65 nënprojekte infrastrukture kryesisht rrugë si edhe kanë përfunduar fazën e garancisë 54 nënprojekte të përfunduara gjatë vitit 2011.

Gjatë kësaj periudhe ka vijuar puna për zbatimin e punimeve civile në 34 nënprojekte të tjera. Ndërkohë janë në proces tenderim/kontraktimi 26 nënprojekte, dhe në përfundim të procesit të përgatitjes së dokumentacionit 68 nënprojekte të tjera. Këto të fundit janë pjesë e financimit të Programit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale, dhe Programit të Ujësjellësive Ruralë.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar rritjes së cilësisë së projektimit, dhe respektimit të standarteve të parashikuara. Të gjitha projektet teknike të objekteve në zbatim, kontrollohen dhe miratohen nga stafi i Departamentit të Infrastrukturës, duke rritur ndjeshëm efektivitetin e këtij procesi.

Zbatimi me cilësi i punimeve dhe rritja e standarteve teknike të aplikuara, është një nga prioritetet institucionale të cilit i është kushtuar një vëmendje e veçantë. Vlen për tu përmendur fakti se në Programin “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore & Lokale”, janë duke u zbatuar standartet e zbatimit dhe supervizimit të punimeve sipas FIDIC.

Supervizimi i punimeve për objektet në zbatim, është duke u kryer nga kompani të huaja dhe vendase me eksperiencë në këtë fushë. Aplikimi i standarteve të larta në supervizimin e punimeve ka sjellë rezultate mjaft të kënaqshme në realizimin me cilësi të punimeve.

Mjedisi, dhe zbatimi i procedurave për ruajtjen e tij ka shoqëruar në çdo moment punën për zbatimin e investimeve në infrastrukturë. Ndjekja me kujdes e këtij komponenti ka bërë të mundur respektimin me rigozitet të parametrave mjedisorë duke aplikuar kështu me sukses një nga parimet themelore të punës në këtë institucion.

## Paraqitja e nënprojekteve sipas donatorëve dhe statusit të tyre Dhjetor 2012

Donatori	Plani i Punës (PP)	Totali	Projekte ne fazen e pergatitjes se dokumentacionit	Në tenderim / vleresim	Në kontraktim	Në zbatim	Projekte te perfunduara Në Garanci	Mbyllur Përfundimisht në Shtator 2012
CEB (CW III)	PP I – IV	45					1	44
KfW (RWS)	PP 1	28	1		2	20	5	
IDA GOA (SLRP)	PP 1	5		1			2	2
OFID I & II (SLRP)	PP 1 & PP 2	14	1			2	7	4
CEB (SLRP)	PP 1 & PP 2	32					28	4
IPA 2008 (SLRP)	PP 1	4					4	
IDB – ISTISNA (SLRP)	PP 1	10			1	3	6	
EBRD, EIB & IPA 2010- 2011(SLRP)	PP 1	41		4	16	9	12	
KfW & IPA 2009 (SLRP)	PP 1	2		2				
Te tjera SLRP		66	66					
<b>TOTALI</b>		<b>247</b>	<b>68</b>	<b>7</b>	<b>19</b>	<b>34</b>	<b>65</b>	<b>54</b>





Deri më 31 Dhjetor 2012, FSHZH ka financuar rikonstrukcionin e 107 segmenteve rrugore dytësore & lokale me një gjatësi totale prej 974 km. Nga këto deri në fund të muajit Dhjetor 2012, janë përfunduar 69 segmente rrugore, me një gjatësi prej 566 km, dhe vijon puna për zbatimin e punimeve civile në 14 rrugë me një gjatësi prej 158 km. Në proces kontraktimi janë 17 segmente rrugore me një gjatësi totale prej 166 km të cilat pritet të fillojnë nga puna në fillim të vitit 2013. Janë në proces tenderimi ose vlerësimi 7 rrugë të tjera dytësore dhe lokale me një gjatësi totale prej 83 km. Ndërkohë janë në fazën e përgatitjes së dokumentacionit teknik 66 segmente të tjera rrugore në të gjithë vendin.

### **Ecuria e deritanishme e projektit**

Komponentët kryesorë të projektit dhe ecuria e secilit prej tyre janë si më poshtë:

**Komponenti i parë:** Financimi i aktiviteteve mbështetëse të programit:

Ky komponent përfshin përgatitjen e bazës së të dhënave për rrugët rurale si dhe përgatitjen e dokumentacionit të prokurimeve për fazën e implementimit.

Baza e të dhënave të prioritizimit është ngritur në fazën e parë duke përbërë një inventar me të dhëna të detajuara për 3500 km, të identifikuar si segmentet kryesore të rrjetit rrugor rural. Këto segmente rrugore janë përzgjedhur nga secili Qark në bazë të prioriteteve e të shpenzimeve aktuale të mirëmbajtjes.

Janë mbledhur të dhëna të hollësishme për të gjithë seksionet rrugore, 525 segmente në total, si popullsia, trafiku, gjendja (ashpërsia e rrugës), aksesit që krijon si edhe varfëria në zona. Është bërë një analizë shumë kriterëshe për secilin nga këto seksione, e përbërë nga disa komponentë.

Procesi i inventarizimit tashmë është një kapacitet i ngritur brenda FSHZH-së dhe po përdoret plotësisht në fazën e dytë të projektit. Paralelisht me zhvillimin e këtij procesi, vijon puna për përditësimin e të dhënave ekzistuese në inventar, duke i rifreskuar me të dhënat aktuale të rrugëve të rikonstruara, ose në proces rehabilitimi. Gjatë vitit 2012, ka vijuar puna për përditësimin e inventarit të rrjetit rrugor rural, përmes programit Romaps, duke rritur numrin e përgjithshëm të inventarit fizik me 437 km. Është punuar kryesisht me informacionin e mbledhur nga projektet që paraqesin gjendjen përfundimtare të rrugës së rikonstruuar si dhe nga filmimet në terren të rrugës. Këto rrugë i janë shtuar inventarit të përgjithshëm si atij fizik dhe atij gjeometrik me të gjitha të dhënat dhe gjeoreferencat përkatëse.

Vlen të theksohet fakti se procesi i inventarizimit të rrjetit rrugor rural do të vijojë, dhe në fund të këtij procesi do të ketë një inventar të saktë të rrjetit rrugor rural në rang kombëtar.

Faza e projektimit, pas dorëzimit të projekteve për 400 km e para nga Roughton International, ka vazhduar me rishikimin e projekteve të hartuara nga NjQV-të si edhe me kontraktimin e konsulencës ndërkombëtare. Aktualisht janë kontraktuar disa kompani të cilat kanë për detyrë përgatitjen e projekteve teknike për 800 km rrugë dytësore dhe lokale në të gjithë vendin, përgatitjen e dokumentave të prokurimit dhe instrumentave mbrojtës shoqëruar. Deri në fund të muajit Dhjetor 2012 janë përgatitur projektet teknike për 580 km të tjera rrugore dytësore dhe lokale.

Një pjesë e segmenteve rrugore të inventarizuara kanë pasur projekte teknike të hartuara nga NjQV-të përkatëse. Këto projekte janë kontrolluar dhe rishikuar nga Njësia e Mbështetjes Teknike pranë FSHZH-së dhe janë cuar për ripunim në rastet kur ka qenë e nevojshme. Per periudhen Janar – Dhjetor 2012, janë kontrolluar dhe ripunuar 93 projekte teknike.

Draft - projektet janë kontrolluar në terren e në zyrë dhe janë bërë komente teknike nga Njësia e Mbështetjes Teknike për përmirësimin e projektit. Pas ripunimit të bërë në bazë të komenteve teknike kompanite kanë përgatitur set-in e dokumentave finale. Kompanitë po vijojnë me projektimin e segmenteve të tjera sipas kontratës.


Në lidhje me ngritjen e kapaciteteve të NjQV-ve përfituese për funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve të reja, vijon trajnimi i tyre nga stafi i FSHZH-së. Përmes tij janë trajnuar 354 komuna e bashki si dhe përfaqësues të qarqeve, në total rreth 740 persona. Gjate periudhes Janar – Dhjetor 2012, ka perfunduar cikli i dyte i trajnimeve ne te gjitha qarqet e Shqiperise. Vetem gjate ketij viti jane trajnuar 203 komuna dhe bashki ne nje total prej 321 persona.

Gjithashtu për llogari të këtij programi, në kuadër edhe të nismës së Qeverisë për të lidhur me rrugë asfaltike të gjitha qendrat e Komunave, është hartuar një bazë e vecantë të dhënash për gjendjen e rrugëve që lidhin qendrat e Komunave me rrugët nacionale apo rajonale.

**Komponenti i dytë** – Financimi i punimeve civile për përmirësimin e rrugëve prioritare rajonale dhe lokale.

### Rrugët e financuara nga Banka Botërore dhe Qeveria Shqiptare.


Banka Botërore ka financuar përmes IDA-s, Programin “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale” me 20 Milionë USD. Këtij investimi i është shtuar dhe një financim prej 5 Milionë USD nga Qeveria Shqiptare. Deri më 31 Dhjetor 2012 me fonde të Bankës Botërore dhe Qeverisë Shqiptare janë financuar 5 projekte për akse rajonale të rëndësishme rrugore në një gjatësi prej 43.2 km. Në fund të muajit Dhjetor 2012, kanë përfunduar punimet në 4 segmente rrugore të financuar nga ky donator, ose 40.5 km, në Qarqet Kukës, Dibër, Fier dhe Tiranë. Ndërkohë si rezultat e menaxhimit të mirë të fondeve nga ky donator, gjatë muajit Dhjetor 2012 është shpallur tenderi për rikonstruksionin e rrugës Dajç – Dragushë me gjatësi 2.7 km.



### Rrugët e financuara nga OFID I & II.

Fondi i OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID) ka financuar programin në dy faza në një total prej 25 Milionë USD. Deri në fund të muajit Dhjetor 2012 nga ky donator janë financuar 13 segmente rrugore dhe 1 ure, në një gjatësi totale prej 108.2 km. Nga këto 11 segmente rrugore dhe 1 ure ose 92.4 km kanë përfunduar punimet civile. Rrugët e përfunduara gjenden në Qarqet Berat, Elbasan, Gjirokastër, Korçë, Lezhë, Shkodër, dhe Vlorë. Kanë përfunduar gjithashtu punimet për rikonstruksionit të urës së Baldushkut.

Grafiku iu referohet segmenteve rrugore të cilat kanë përfunduar punimet civile dhe atyre që janë në proces zbatimi. Ndërkohë vijojnë punimet në 2 segmente rrugore të financuara nga OFID II në një gjatësi prej 15.84 km.




### Rrugët e financuara nga Banka e Këshillit të Europës (CEB).

Banka e Këshillit të Europës (CEB) ka financuar Programin “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale” me 40 Milionë Euro. Me këto fonde deri në fund të muajit Dhjetor 2012 janë financuar 32 segmente rrugore me një gjatësi totale prej 249 km. Punimet civile kanë përfunduar në të gjitha rrugët e financuara nga ky donator.

Grafiku iu referohet 32 segmenteve të financuara deri në Dhjetor 2012 nga Banka e Këshillit të Europës..

Rrugët e përfunduara janë vënë në funksionim të plotë. Ato janë në periudhë garancie dhe mbikqyren për një periudhë 1 vjeçare nga supervizori dhe stafi teknik i FSHZH duke garantuar cilësinë e punimeve dhe qëndrueshmërinë e rrugëve.



### Rrugët e financuara nga IPA 2008 – Delegacioni i Bashkimit Europian.

Delegacioni European ka financuar këtë program përmes IPA 2008 me shumën 11 Milionë USD, për rikonstruksionin e katër segmenteve rrugore, me një gjatësi 34 km. Për këto segmente procedurat kanë qenë të centralizuara, pra prokurimi dhe supervizimi i punimeve janë organizuar nga vetë Delegacioni i Bashkimit Europian.

Gjatë vitit 2011, kanë përfunduar punimet në te 4 segmentet rrugore në Qarqet Durrës, Gjirokastër, Shkoder, dhe Lezhë.


### Rrugët e financuara nga Banka Islamike për Zhvillim dhe Qeveria Shqiptare (IDB & GoA).

Banka Islamike për Zhvillim ka financuar Programin “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore & Lokale” në shumën prej 40 Milionë USD. Këtij financimi i është shtuar dhe një kontribut i Qeverisë Shqiptare në vlerën 4 Milionë USD.

Deri në Dhjetor 2012, janë financuar 10 segmente rrugore ose 90 km.

Nga këto kanë përfunduar punimet civile për 6 segmente rrugore në një gjatësi prej 65.04 km. Në proces zbatimi janë 3 segmente rrugore me një gjatësi prej 17.41 km. Ndërkohë është në proces tenderimi / kontraktimi edhe 1 rrugë të tjera me një gjatësi totale prej 7.4 km.

Kanë përfunduar punimet në akset rrugore Kam – Golaj, Ura e Mesit – Prekal, Ura Gjader – Mnelë, Fshat i Ri – Kukel, Sheshi i trageteve – Lekbibaj dhe Ura Dushaj – Sheshi i trageteve.




### Rrugët e financuara nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), Banka Europiane e Investimeve (EIB), IPA 2010 - 2011.

EBRD, EIB, IPA 2010, IPA 2011 kanë financuar këtë program me 138.5 Milionë Euro. Në marrëveshjen e financimit është vendosur që fondet e këtyre donatorëve të menaxhohen si një financim i vetëm. Deri në Dhjetor 2012, me këto fonde janë financuar 41 segmente rrugore në një gjatësi prej 421 km.

Deri ne Dhjetor 2012 kanë përfunduar punimet në 12 akse rrugore me një gjatësi prej 85.26 km. Vijnë punimet në 9 segmente rrugore me një gjatësi prej 125.51 km. Ne proces kontraktimi janë 16 segmente rrugore ose 158.84 km.

Ndërkohë 4 segmente rrugore ose 51.3 km janë në proces tenderim – vlerësimi.

Ecuria e përgjithshme e gjithë projekteve ka qenë pozitive dhe mund të thuhet se standartet e reja të aplikuara në këtë projekt po japin rezultate të mira në lidhje me cilësinë e punimeve.



## **Financimi i KfW dhe IPA 2009**

KfW dhe IPA 2009 kanë financuar këtë program përkatësisht me 15 dhe 8.8 Milionë Euro. Në marrëveshjen e financimit është vendosur që fondet e këtyre donatorëve të menaxhohen si një i vetëm. Me këto fonde parashikohet financimi i rreth 80 km rrugë në Qarqet Kukës, Dibër dhe Shkodër. Aktualisht kanë përfunduar projektet teknike për të gjitha segmentet rrugore të parashikuara për financim, dhe është duke u zhvilluar procesi i konsultimit me publikun. Ndërkohë është hapur procesi i tenderimit për 2 segmente rrugore “Rruga nacionale – Qelëz” dhe “Rruga nacionale – Iballë”, ne rrethin e Pukës, Qarku Shkodër. Prosesi i tenderimit për segmentet e tjera rrugore parashikohet të kryhet gjatë tremujorit të parë të vitit 2013.

## **Prokurimi**

Procedurat e prokurimit për punimet civile në këtë program janë kryer në përputhje me Udhëzuesit e Bankës Botërore “Guidelines: Procurement Under IBRD Loans and IDA Credits Procurement”.

Rrugët e financuara nga BERZH dhe BEI janë prokuruar në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në Marrëveshjen e Financimit të Projektit për Rrugët Dytësore dhe Lokale dhe Udhëzuesit e Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim publikuar në Janar të 1992 dhe rishikuar në Maj të 2010.

Rrugët e financuara nga Banka Botërore, GoA, OFID, dhe CEB, janë tenderuar sipas metodës “tender i hapur ndërkombëtar”.

Ndërkohë prokurimi i punimeve civile për rrugët e financuara nga IDB, po kryhet sipas metodës “tender i hapur kombëtar”.

Rrugët e financuara nga KfW dhe IPA 2009 do të tenderohen sipas metodës “tender i hapur ndërkombëtar”.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2012, janë shpallur për tenderim ose tenderuar 27 segmente rrugore.

## **Supervizimi i kontratave të punimeve civile**

Kompania Louis Berger SAS e cila është e kontraktuar për supervizimin e punimeve civile, aktualisht po kryen supervizimin e implementimit të 14 kontratave të punimeve, të cilat janë bazuar në FIDIC. Ndërkohë është ndjekur supervizimi i 49 rrugëve të tjera të cilat kanë përfunduar zbatimin e punimeve civile, dhe mbikqyren edhe gjatë periudhës së garancisë.

## **Procedurat mjedisore**

Në kuadrin e projektit “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”, ka vazhduar paralelisht edhe ndjekja e procedurave mjedisore sic parashikohen në Manualin e Procedurave dhe në kërkesat e projektit. Gjatë vitit 2012, puna është përqëndruar në këto aktivitete të lidhura me mjedisin:

- Kontrolli i zbatimit të Planit të Menaxhimit të Mjedisit, hartuar nga Njësia e Mjedisit.
- Raportimi periodik mujor lidhur me kriteret mjedisore gjatë zbatimit të punimeve civile;

- Ndjekja periodike e mekanzimit te aplikimit të penaliteteve të kontraktoreve që nuk i plotësojnë kriteret mjedisore gjatë zbatimit të punimeve;
- Trajnime të lidhur me "Plotësimin e kriterëve mjedisore, sociale dhe sigurisë rrugore gjatë zbatimit të nënprojekteve të FSHZH", me pjesëmarrjen e kompanive kontraktore, inspektorët, si dhe përfaqësues të kompanisë supervizuese.
- Kontrolli i cilësisë së raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të hartuar nga kompania projektuese Sphaera/AIC, konsulentët e përzgjedhur nga FSHZH, si dhe nga ana e NjQV.
- Lehtësimi i procesit të aplikimit për leje mjedisore në Qendrën Kombëtare të Liçensimit dhe sigurimi i lejeve mjedisore.

**Konkluzione:**

Projekti ka paraqitur një performancë shumë të kënaqshme në të gjithë komponentët e tij.

FSHZH si agjenci implementuese e këtij programi po vazhdon të kryejë me sukses rolin e saj në monitorimin, koordinimin dhe implementimin e shpejtë të këtij programi, duke garantuar realizimin me cilësi dhe përgjegjshmëri të të gjitha objektivave të zbatimit të programit.

Vitit 2012 shënoi financimin e rreth 1000 km rrugë dytësore dhe lokale në të gjithë vendin, duke plotësuar që këtë vit objektivat dhe pritshmëritë e programit i cili ka pasur si objektiv fillestar rehabilitimin e 1000 km. Deri në vitin 2015 i cili është dhe viti i përfundimit të programit, parashikohet financimi dhe rehabilitimi i rreth 1500 km rrugë.

Ecuria e financimit ka treguar progres dhe rezulton që deri në Dhjetor 2012 janë në proces zbatimi 368 Milionë USD. Kësaj shume pritet ti shtohen edhe financime të tjera të cilat janë në negociim me Agjencinë Japoneze për Zhvillim Ndërkombëtar (JICA), dhe Bankën e Këshillit të Europës për Zhvillim (CEB), e cila do të rifinancojë me një paketë të dytë financiare. Së bashku me këto financime programi parashikohet të tejkalojë ndjeshëm shumën prej 400 Milionë USD të vendosur si objektiv në fillim të tij.

## 2.2 Programi “Punët në komunitet III” financiar nga CEB


Programi “Punët në komunitet III” financohet nga CEB dhe Qeveria Shqiptare në vlerën 14.53 milionë Euro, dhe ka si qëllim të nxisë zhvillimin social ekonomik të zonave rurale të vendit, të cilat kanë potenciale të zhvillimit ekonomik, veçanërisht në turizëm.

DONATORËT	SHUMA E FINANCIAR
Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës (CEB) & NTA	10,180,000 Euro
Qeveria e Shqipërisë (GoA)	2,950,962 Euro
Kontributi Lokal (LC) <sup>2</sup>	1,404,647 Euro
<b>Totali</b>	<b>14,535,609 Euro</b>

Në program janë përfshirë 16 komuna, të cilat janë të shpërndara gjeografikisht, dhe kanë tipare të veçanta të turizmit (komunat aplikojnë forma të ndryshme të turizmit bregdetar, malor, historik, eko-turizëm, agro-turizëm, etj), dhe nevoja të ndryshme në aspektin e ndërtimit të kapaciteteve. Programi ofron asistencë teknike të diversifikuar që ndryshon nga komuna në komunë dhe përshtatet në përputhje me nevojat që përballen stafi dhe të zgjedhurit lokalë në secilën prej tyre.

Programi është i lokalizuar në NjQV-të si vijon: Drenovë, Tregan, Fushë-Kuqe, Orikum, Qendër Vlorë, Dermenas, Kryevidh, Petran, Kutalli, Ulëz, Ishëm, Margegaj, Postribë, Velipojë, Rrashbull, Petrelë.

Programi “Punët në Komunitet III”, mund të konsiderohet i finalizuar me sukses. Muaji Mars shënoi përfundimin e punimeve civile edhe për objektin e fundit të infrastrukturës të financuar në kuadër të këtij programi.



### Komponenti i Asistencës teknike për ngritjen e kapaciteteve

Nën këtë komponent kanë përfunduar dhe janë vënë në dispozicion të NjQV-ve, planet e zhvillimit lokal për komunat Tregan, Fushë-Kuqe, Kutalli, Drenovë dhe Bashkinë Orikum. Gjithashtu janë hartuar Planet Hapësinore për komunat Petrelë, Ulëz dhe Velipojë. Janë hartuar edhe Plane Zhvillimi të Turizmit për komunat Ishëm, Kryevidh, Qendër Vlorë dhe Petran. Aktivitetet kryesore të këtij komponenti kanë qenë të lidhura me ndërtimin e kapaciteteve lokale dhe me zhvillimin e produkteve të rëndësishme promovuese.

<sup>2</sup> Në fillim të projektit ishte parashikuar që kontributi lokal të ishte 1,240,000 Euro. Gjate zbatimit të projektit rezultoi që kontributi lokal është në vlerën 1,512,875 Euro ose 272,875 Euro më shumë se sa parashikimi. Rritja e vlerës së kontributit lokal i atribuohet financimit të nenprojekteve infrastrukturore në NjQV-në Orikum, ku kontributi lokal qenë më i madh se sa parashikimi.



## **Komponenti i përmirësimit të infrastrukturës**

Përsa i përket komponentit të përmirësimit të infrastrukturës në këto komuna, janë financuar gjithsej 45 nënprojekte të infrastrukturës, të cilat kanë përfunduar punimet civile dhe janë vënë në funksionim të plotë.

Për lehtësi të menaxhimit projekti është ndarë në katër faza ose plane pune. Në fazën e parë u financuan 16 nënprojekte të cilat kanë përfunduar fazën e garancisë. Në fazën e dytë janë financuar 14 nënprojekte të cilat janë finalizuar dhe kanë përfunduar periudhën e garancisë. Në fazën e tretë janë finalizuar 9 objekte të cilët kanë përfunduar periudhën e garancisë. Në fazën e katërt u përzgjedhën për financim 6 nënprojekte të infrastrukturës të cilat kanë përfunduar punimet civile. Gjatë muajit Prill përfundoi punimet dhe objekti i fundit i kësaj faze, “Rikonstruksioni i rrugës Shetaj – Kisha Skenderbej”. Nga këto 5 nënprojekte kanë përfunduar periudhën e garancisë dhe 1 tjetër është ende periudhë garancie.

Të gjitha objektet e financuara në kuadër të këtij projekti, janë me cilësi dhe të vlerësuara pozitivisht nga komunitetet përfituese. Është treguar kujdes i vecantë, për inspektimin e punimeve, jo vetëm nga supervizorët e kontraktuar, por edhe stafi teknik i FSHZH. Nga ana tjetër i është kushtuar vëmendje e vecantë, përgatitjes së projekteve teknike, duke i plotësuar ato me detajet e nevojshme. Për objektet e përfunduara, ka vijuar puna për sensibilizimin dhe marrjen e masave nga Komunitat përfituese, për një mirëmbajtje sa më të mirë dhe efikase të objekteve pas përfundimit të tyre.

## **Prokurimi**

Procesi i Prokurimit të punimeve civile është drejtuar dhe ka qenë nën përgjegjësinë e Komunave pjesëmarrëse në program. FSHZH ka ndjekur nga afër dhe ka miratuar zbatimin e procedurave të tenderimit për të gjitha kontratat e realizuara. Monitorimi i procesit të prokurimit për këto kategori, ka treguar se procesi ka qenë transparent dhe korrekt, në përputhje me procedurat ligjore në fuqi.

## **Procedurat mjedisore**

Në kuadër të zbatimit të procedurave për mbrojtjen e mjedisit të programit “Punët në Komunitet III”, gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2012 është kryer një vlerësim përfundimtar mbi ndikimet në mjedis dhe problemet mjedisore të raportuara gjatë zbatimit të projekteve të këtij programi.

## **Konkluzione:**

Programi “Punët në Komunitet III”, konsiderohet i përfunduar me sukses. Muaji Prill 2012 shënoi dhe përfundimin e punimeve civile për objektin e fundit, duke çuar kështu në finalizimin me sukses të 45 nënprojekteve infrastrukturore të financuara. Komponenti i ngritjes së kapaciteteve lokale ka përfunduar me sukses duke siguruar mbështetje shumëplanëshe për komunitetet përfituese të këtij projekti. Projekti ka konsoliduar zhvillimin e qëndrueshëm të 16 komunave duke i pajisur ato me Plane Zhvillimi, si dhe duke i mbështetur këto plane me projekte të rëndësishme infrastrukturore. Një arritje e këtij projekti është edhe ngritja e kapaciteteve brenda FSHZH-se, të cilat janë një mjet i mirë për të asistuar në mënyrë të vazhdueshme NjQV-të në ngritjen e kapaciteteve.


Programi mund të thuhet se ka përmbushur plotësisht objektivat e vendosura në fillim të zbatimit të tij.

### 2.3 Programi “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale” financuar nga KfW

Programi “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale” financuar nga KfW, konsiston në ndërtimin e 26 skemave të ujësjellësave rurale në 50 fshatra në Qarqet Diber, Shkodër dhe Kukës, duke kontribuar në përmirësimin e jetesës së rreth 40.000 banorëve. Programi ka një kohëzgjatje 6 vjeçare dhe përfundon në fund të vitit 2014. Vlera e programit është 11.66 milionë Euro (7.5 Milionë + 1.5 Milionë) për masat investuese, 1 Milionë Euro Grant për ngritje kapacitetesh, masat shoqëruese, dhe 1.66 milionë Euro kontribut i GoA & përfituesve të drejtpërdrejtë). Në muajin Mars 2011, Kuvendi i Shqipërisë ratifikoi marrëveshjen me KfW, për financimin e fazës së dytë të Programit “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale”, në vlerën 5 Milionë Euro dhe 0.8 Milione Euro te tjera që do të jenë kontribut lokal nga NjQV-te përfituese.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2012, programi ka zhvilluar një aktivitet intensiv për zbatimin e punimeve civile në 25 skema ujësjellësash të financuar, por edhe për ngritjen e kapaciteteve lokale lidhur me funksionim – mirëmbajtjen dhe administrimin të ujësjellësave. Në fund të muajit Dhjetor 2012, rezultoi se punimet civile për ndërtimin e ujësjellësave kanë përfunduar në 6 kontrata që përfaqësojnë 13 skema ujësjellësash, duke mundur furnizimin me ujë të pijshëm dhe higjienikisht të pastër, për më shumë se 28 fshatra në qarqet Diber, Kukës dhe Shkodër. Ndërkohë punimet vijojnë për 3 kontrata që përfaqësojnë 12 skema ujësjellësash. Për një skemë tjetër pritet financimi nga DPUK për linjën kryesore.

Me fondin rezervë të programit, janë hartuar fizibilitetet për ndërtimin e ujësjellësave të 5 fshatrave në Komunitatet Postribë dhe Tropoje e Vjetër, në qarqet Shkodër dhe Kukës. Janë hartuar projektet teknike dhe gjatë muajit Nentor 2012 janë lidhur kontratat me 4 kontraktore për këto skema. Muaji Dhjetor 2012 shënoi fillimin e punimeve edhe për këto 4 skema. Parashikohet që në Qershor 2013, punimet të përfundojnë edhe për këto skema.



Aktivitetet kryesore të zhvilluara në kuadër të zbatimit të projektit kanë qenë:

- Në fazën e parë u krye identifikimi i nevojave për ujësjellesa në qarqet e Dibrës, Kukësit, dhe Shkodrës. Për këtë u bashkëpunua ngushtë me Njësitë e Qeverisjes Vendore, dhe Konsulencën e kontraktuar për zbatimin e këtij Programi.
- Në fazën e dytë u hartuan fizibilitetet teknike dhe sociale për të gjithë ujësjellësat. Për përzgjedhjen e ujësjellësave pjesëmarrës në program, u hartua një bazë të dhënash me tregues socialë dhe teknike të cilët u përdorën për të përzgjedhur 28 skema ujësjellësash.
- Në fazën e tretë, e cila shënon dhe fazën e implementimit të programit, u hartuan projektet teknike, dhe u përgatit dokumentacioni i tenderimit për të gjitha skemat fituese. U shpallën tenderat për 25 skema dhe u lidhen 10 kontrata për zbatimin e punimeve civile që përfaqësojnë 25 skema ujësjellësash.
- Gjatë implementimit të këtij programi një rëndësi e vecantë i është kushtuar masave shoqëruese dhe ngritjes së kapaciteteve. Në këtë kuadër është kryer hartimi i draftit të manualit Financiar dhe Komercial, i cili është testuar në 4 Komuna. Ka përfunduar hartimi i draftit të Manualit të Funkcionim Mirëmbajtjes. Ndërkohë është hartuar drafti i Strategjisë së Komunikimit dhe Rritjes së Ndërgjegjësimit.
- Janë kryer takime informimi dhe orientimi me Grupet e Përfituesve të Ujit, për të gjitha skemat e ujësjellësave pjesëmarrës në program. Janë kryer një seri takimesh me komunitetin, me qëllim sensibilizimin, evidentimin dhe zgjidhjen e problemeve sociale. Për të gjitha skemat janë kryer konsultime me publikun për të diskutuar Draftin Teknik të Projektit dhe çështjet mjedisore. Eshtë ofruar asistencë teknike dhe ligjore për procedurat e aplikimit për Licencë si Operatorë të Shpërndarjes së Ujit, në komunat Shupenzë, Hajmel, Baz dhe Melan.
- Eshtë përgatitur baza e të dhënave me nevojat për ujësjellësa në komunat e Qarqeve Kukës, Dibër dhe Shkodër për programin SIF IV. Eshtë punuar në përzgjedhjen e kompanisë së konsulencës së huaj si dhe për përzgjedhjen e kompanisë për hartimin e projekteve dhe supervizionin për Programin SIF IV.
- Në kuadër të SIF IV, janë përgatitur fizibilitetet teknike për rreth 41 fshatra, nga të cilat do të përzgjidhen 20-25 fshatra bazuar në kriterin e kostos. Në bashkëpunim me asistencën e re teknike KOCKS, është duke u punuar për të përmirësuar fizibilitetin standard teknik duke bërë azhurnimet përkatëse.
- Eshtë realizuar Studimi i Fizibilitetit për 20 fshatrat e cili shërbeu për përzgjedhjen e 5 prej tyre që u financuan nga fondi rezervë i programit në shumën 1 Milion Euro. Janë hartuar projektet teknike për 5 fshatrat e përzgjedhur si dhe janë lidhur kontrata me katër firma kontraktore. Punimet filluan gjatë muajit Dhjetor 2012. Komunat përfituese Tropoje e Vjeter dhe Postribë kanë paguar pjesën e parë prej afro 3% të kontributit lokal.
- Më datë 30 Mars 2012, Njësia e Projekteve Hidroteknike pranë FSHZH organizoi Seminarin me temë Funkcionim – Mirëmbajtja e Ujësjellësve Rurale, ku morën pjesë përfaqësues të Komunave të Qarkut Dibër, Entit Rregullator të Ujit, Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizimeve, KfW, Shoqatës së Ujësjellës Kanalizimeve të Shqipërisë, etj.
- Departamenti i Zhvillimit Rajonal në bashkëpunim me Njësinë e Ujësjellësve Ruralë ka koordinuar punën me një konsulent ndërkombëtar të kontraktuar nga një fond Grant i KfW-së për skicimin e një programi të tretë në mbështetje të ujësjellësve ruralë në vend.

dhe me gjerë krijimin e një inventari për gjendjen aktuale të ujësjellësve ruralë dhe nevojave për investim.

- Ne bashkepunim me CES, NjPH ne periudhen Prill-Gusht ka vijuar programin e trajnimeve me stafin teknik dhe financiar te komunave per funksionimin dhe mirembajtjen e ujesjellesave rurale per 25 komuna. Gjate kesaj periudhe jane trajnuar 70 teknike te funksionimit dhe te mirembajtjes dhe 37 specialiste te tregetit dhe financiere te sherbimit te ujesjellesit. Jane realizuar ne total 24 seanca trajnimi ne terren dhe 8 seanca trajnimi ne qendren e Trainimeve prane FSHZH.

### **Vështirësi të hasura gjatë implementimit të programit**

Gjatë zbatimit të këtij programi janë hasur edhe vështirësi të lidhura me pronësinë e burimeve dhe zonat ku kalojnë linjat e ujësjellësit. Situatat të cilat kanë qenë të izoluara, janë zgjidhur rast pas rasti në bashkepunim me komunitetin dhe qeverisjen lokale.

Gjithashtu në disa raste janë vërejtur mungesa në personel dhe vështirësi financiare të komunave të cilat kanë qenë të rëndësishme vecanërisht në fazën e pagimit të kontributit.

Në pjesën me te madhe te NjQV-ve vihet re edhe mungesë e përvojës për Organizimin e Shërbimit të Furnizimit me Ujë (shërbim i licensuar sipas ligjeve në fuqi).

Situata e krijuar nga kushtet e vështira të motit gjatë periudhës Shkurt – Mars 2012, situatë kjo e emergjencave civile e shpallur me vendim Qeverie, bëri që punimet të pezullohen gjatë kësaj periudhe. Ky fakt ndikoi në shtyrjen e afateve te përfundimit të parashikuar të Kontratave.

Në vijim të punës për realizimin me sukses të projektit, gjatë vitit 2013, parashikohen një sërë aktivitete të rëndësishme. Disa nga aktivitetet e parashikuara për këtë periudhë kohore janë :

- Përfundimi i punimeve për 100% të nënprojekteve;
- Trajnimi i stafit të komunave për funksionimin dhe mirëmbajtjen e skemave të ujësjellësive sipas Programit të Trainimit;
- Trajnimi i stafit të komunave mbi procedurat tregëtare & financiare, dhe funksionim -mirembajtjen sipas Programit të Trainimit;
- Bashkëpunim dhe mbështetje për Komunitet e PUR për organizimin e Shërbimit të furnizimit me ujë në nivel Komune;
- Bashkëpunim dhe mbështetje për Komunitet e përzgjedhura në procedurat e aplikimit për Licencë si Operatorë të Shpërndarjes së Ujit dhe për aprovimin e tarifave të ujit;
- Përgatitja dhe implementimi i fushatës sensibilizuese/ndërgjegjësuere për aspektet higjieno-sanitare gjatë përdorimit të ujit;
- Hartimi i kriterëve dhe përgatitja e Short-Listës për projektet e programit SIF IV dhe realizimi i fizibiliteteve për projektet e saj dhe Lista Finale për investim;
- Fillimi i zbatimit dhe nënshkrimi i angazhimit paraprak për projektet fituese per SIF IV;

## Prokurimi

Gjatë vitit 2011, janë shpallur tenderat për punimet civile të 25 skemave të ujësjellësave të financuar në kuadër të këtij programi, dhe janë përzgjedhur fituesit për 10 lotet. Procedurat e prokurimit për punimet civile u kryhen sipas metodës “tender i hapur kombëtar”. Gjatë vitit 2013, parashikohet që të zhvillohet tenderi për skemat e përzgjedhura për investim të programit SIF IV sipas procedurave përkatëse.

## Procedurat mjedisore

Në kuadër të zbatimit të procedurave për mbrojtjen e mjedisit të programit “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale”, janë kryer këto aktivitete:

- Janë hartuar fizibilitetet mjedisore dhe Planet e Menaxhimit të Mjedisit për të gjitha skemat e ujësjellësve;
- Janë duke u ndjekur procedurat mjedisore dhe përgatitja e lejeve mjedisore për skemat e reja që u futen me fondet e kontigjencës së programit SIF III.
- Gjatë vitit 2013, krahas përgatitjes së fizibiliteteve teknike dhe projekteve për skemat e përzgjedhura, do të vijojnë procedurat mjedisore për plotësimin me leje mjedisore.

## Konkluzione:

Programi është në fazën e përfundimit të punimeve infrastrukturore për 25 skema ujësjellësish. Ecuria e projektit si në zbatimin e punimeve ashtu edhe në zbatimin e masave shoqëruese shfaqet e kenaqshme. Janë shfaqur vështirësi lidhur me kapacitetet menaxhuese të disa komunave apo me mungesën e përvojës në Organizimin e Shërbimit të Furnizimit me Ujë nga ana e tyre, të cilat janë të kufizuara dhe nuk përbëjnë risk në arritjen e objektivave. Parashikohet që muaji Qershor 2013 të shënojë përfundimin e punimeve civile në të gjitha skemat e ujësjellësave të financuar dhe të fillojë faza e funksionimit dhe mirëmbajtjes së tyre. Menaxhimi profesional dhe zbatimi i kënaqshëm i këtij programi, ka rezultuar me përfitimin e një financimi të dytë nga ana e KfW-së për këtë program në vlerën prej 5.8 Milionë Euro.

## 2.4 Bashkëpunimi i FSHZH me Komitetin e Zhvillimit të Rajoneve në kuadër të Projekteve të Infrastrukturës Vendore

Edhe gjatë vitit 2012, FSHZH është angazhuar për vlerësimin teknik të projekteve të infrastrukturës lokale, në ndihmë të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

Gjate këtij viti është ndjekur ecuria tekniko – financiare e objekteve të miratuar në vitin 2011 si edhe disa objekteve të trasheguara nga vitet 2009-2011. Paralelisht ndjekjes dhe monitorimit të objekteve në vazhdim, në periudhën Mars - Prill 2012 u vlerësuan rreth 330 objekte të infrastrukturës rrugore, nga të cilat bazuar në vendimet e FZHR-së për financim nga buxheti i vitit 2012, janë miratuar 123 objekte në vlerën 485.802.638 lekë.

Rregjistrimi i kërkesave të NjQV-ve, vlerësimi teknik, social ekonomik si dhe raportimi i informacionit nga FSHZH, është kryer me shumë profesionalizem dhe transparencë.

Gjatë muajit Nëntor 2012, bazuar në kërkesën e Fondit të Zhvillimit të Rajoneve u krye azhurnimi i statusit të avancimit teknik dhe financiar për objektet e financuara gjatë vitit 2011 si dhe objektet e miratuar për vitin 2012.

## **2.5 Ndryshimi i 9 kalave kryesore të Shqipërisë në kuadër të 100-vjetorit të Pavarësisë**

Me rastin e 100 vjetorit të Pavarësisë së vendit FSHZH përgatiti dhe realizoi një projekt për ndryshimin e mureve rrethuese të 9 kalave kryesore të Shqipërisë. Kalatë e përfshira në këtë projekt janë: Kalaja e Krujës, Elbasanit, Beratit, Lezhës, Kaninës, Gjirokastrës, Shkodrës, Prezës dhe Petrelës.

Nëpërmjet këtij investimi, FSHZH synoi të kontribuojë në afirmimin e vlerave historike dhe kulturore të vendit si edhe në rritjen e të ardhurave të njësisë vendore të përfshira në të, nëpërmjet promovimit dhe rritjes së aksesit në objektet e trashëgimisë kulturore.

Gjithashtu, synoi që ti jepet rëndësia e duhur këtyre elementëve të trashëgimisë kulturore duke afirmuar vlerat historike dhe kulturore të Shqipërisë, në funksion të një fryme positive kombëtare dhe komunitare.

Në realizimin e këtij projekti, FSHZH bashkëpunoi ngushtë me Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve si edhe me njësitë e qeverisjes vendore që kanë në territorin e tyre këto kala.

Punimet në këto kala u realizuan dhe me bashkëpunimin e Institutit të Monumenteve të Kulturës për të garantuar ruajtjen e vlerave të objektivave të trashëgimisë kulturore.

### 3. AKTIVITETI INSTITUCIONAL

#### 3.1 Menaxhimi Financiar

Analiza financiare për vitin 2012, bazuar në sistemin raportues të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, jep informacion kryesisht mbi funksionet kryesore financiare: planifikimin, kontabilitetin, menaxhimin financiar të investimeve dhe atë operativ-administrativ.

Gjatë këtij viti, janë bërë përpjekje për ruajtjen dhe garantimin e ekuilibrave financiarë të institucionit në mënyrë që i gjithë aktiviteti ekonomik - financiar i tij të jetë i organizuar brenda limiteve të lejuara të financimit. Gjithashtu vëmendje i është kushtuar administrimit dhe menaxhimit të fondeve me përgjegjshmëri dhe transparencë, si dhe monitorimit dhe mbikqyrjes së detajuar të fondeve sipas komponentëve përkatës: investime në infrastrukturë, administrim të brendshëm, asistencë teknike, etj.

Gjatë këtij viti, FSHZH ka arritur një realizim financiar në vlerën 76.75 Milionë USD ose në masën 94 % kundrejt buxhetit vjetor.

Në kuadër të Projektit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale, Projektit të Ujësjetësive Rurale dhe Projektit të Punëve në Komunitet III është ndjekur zbatimi i punimeve dhe i periudhës së garancisë për 98 kontrata për punime civile, kryesisht rrugë dhe ujësjellësa, me vlerë rreth 240 milionë USD. Vetëm gjatë tremujorit të fundit e këtij viti janë lidhur 15 kontrata.

Për realizimin buxhetor janë ndjekur me përpikmëri plani i punës dhe procedurat e përcaktuara në marrëveshjet e nënshkruara me donatorët si dhe legjislacioni shqiptar.

Pasqyrat financiare, që paraqiten më poshtë, përmbajnë të dhëna progresive të cilat krijojnë një skenar të qartë të mjedisit ekonomik - financiar dhe të performancës së aktivitetit të FSHZH-së gjatë kësaj periudhe, si dhe një analizë në nivelin strukturor të shpenzimeve dhe të të ardhurave duke paraqitur në këtë mënyrë raportin si edhe peshën specifike të kategorive dhe komponentëve të veçantë.

#### Të ardhurat e FSHZH-së

Gjatë këtij viti, FSHZH ka menaxhuar fondet e akorduara nga donatorët e huaj dhe Qeveria Shqiptare në kuadër të 3 Programeve në zbatim.

Aktualisht FSHZH ka në ndjekje financiare këto programe:

- Programi “Rrugët Dytësore dhe Lokale” – financuar nga Banka Botërore, OFID, CEB, IDB, ISTISNA, EIB, EBRD dhe Qeveria Shqiptare ;
- Programi “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale – financuar nga KFW, Qeveria Shqiptare dhe përfituesit e drejtpërdrejtë;
- Programi “Punët në Komunitet III” - financuar nga Banka e Këshillit të Europës (CEB), Qeveria Shqiptare si dhe përfituesit e drejtpërdrejtë;
- Kontributi i komunave (përfituesit) në masën 10 % të vlerës së investimit si bashkëfinancim në projektet në zbatim që zbatojnë këtë kriter.

### **Disbursimi i Fondeve gjatë vitit 2012 sipas Programeve**

Gjatë këtij viti, në përputhje me kërkesat për financime, janë disbursuar nga donatorët e huaj rreth 66.04 Milionë USD sipas Programeve si më poshtë:

- Për Programin e Rrugëve Dytësore dhe Lokale gjatë këtij viti janë disbursuar rreth 59.40 Milionë USD nga të cilat IDA 4.11 Milionë USD, OPEC 3.56 Milionë USD, EBRD & EIB & IPA KFW 33.20 Milionë USD, IDB & ISTISNA –14,05 Milionë USD, CEB SLR 3.34 Milionë USD dhe të tjerë bashkefinancues 1.14 Milionë USD (Devolli HD).
- Për Programin “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale” KFW IV janë disbursuar 6.44 Milionë USD.
- Për Programin e Punëve të Komunitetit III janë disbursuar 200 mijë USD

Fondet e akorduara nga Qeveria Shqiptare për vitin 2012 për të gjitha projektet e reja dhe në vazhdim në komponentët Investime, Kosto Lokale dhe TVSH janë në vlerën 14.42 Milionë USD.

### **Të ardhura të tjera**


Gjatë aktivitetit ekonomik-financiar të saj, FSHZH realizon hyrje të vlerave monetare (të ardhura) në vlera të pakta nga aktivitetet dytësore si: shitje të dokumentave të tenderave, investime të likuiditeteve në Lekë (vendosje depozite me afat), të ardhura për shërbime të kryera nga institucioni si seleksionimi i projekteve për Grantet konkurruese, etj.

Gjatë këtij viti janë vendosur depozita me afat, 3 mujor dhe 6 mujor për fondet në lekë përkohësisht të lira duke u ndjekur procedurat e përcaktuara në Vendimin e Komitetit Ekzekutiv për përzgjedhjen e ofertës më të mirë ofruar nga Bankat të cilat operojnë sot në treg. Vlera e të ardhurave të përfituara gjatë këtij viti është rreth 319 mijë USD, nga shitja e dokumentave për tender, interesat e depozitave me afat dhe garancite bankare.



## Shpenzimet dhe Realizimi i Zërave të Buxhetit për vitin 2012

Gjatë këtij viti FSHZH ka menaxhuar një fond prej 76.75 Milionë USD, me një realizim financiar në masën 94 % të buxhetit vjetor 2012. Realizimi financiar paraqitet më poshtë i ndarë sipas komponentëve respektivë:



### Infrastruktura

Ky zë përbën aktivitetin kryesor të Institucionit dhe përfaqëson investimet në infrastrukturë kryesisht për rrugë dhe ujësjellësa. Si komponent është realizuar në një vlerë prej rreth 70.55 Milionë USD ose në masën prej 96 % kundrejt buxhetit vjetor.

(Tabela bashkëngjitur “Realizimi i zërave të Buxhetit për periudhen Janar - Dhjetor 2012”).

### Realizimi financiar per periudhen Janar - Dhjetor 2012 për kategorinë “Investime”

Programet	Realizimi në % kundrejt realizimit vjetor 2012	Realizimi në vlerë (shprehur në USD)
Investime Qeveria Shqiptare+TVSH	20.10 %	14,178,726
Përfituesit	1.5%	1,061,794
Punët në Komunitet III (CEB)	1 %	740,449
Rrugët Dytësore dhe Lokale (IDA, CEB, OPEC, EIB & EBRD, IDB ISTISNA)	68.90 %	48,603,044
Furnizmi me Ujë i Zonave Rurale (KfW)	8.50%	5,968,880
<b>Totali</b>	<b>100%</b>	<b>70,552,893</b>

## **Projektim Supervizimi**

Ky zë është realizuar në vlerën 3.389 Milionë USD ose në një masë prej 76 % kundrejt Buxhetit vjetor 2012.

Në këtë komponent janë përfshirë rreth 1.784 Milione USD shpenzime për kontratën e supervizionit me kompaninë Louis Berger e cila kryen supervizionin e punimeve në kuadër të Projektit të Rrugëve Dytësore & Lokale, 509 mijë USD për kontratën e projektimit me kompaninë JV AIC Progetti & Sphaera financuar nga EIB Grant në kuadër të Programit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale, 736 mijë USD financuar nga IDB në kuadër të Programit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale, rreth 80 mijë USD shpenzime për kontratat e projektim supervizionit në kuadër të Projektit të Punëve në Komunitet III financuar 100% nga Qeveria Shqiptare, 111 mijë USD në kuadër të Projektit të Furnizimit me Ujë të Zonave Rurale – KfW si dhe 169 mijë USD financuar nga IPA-KfW në kuadër të Programit “Përmirësimi i Rrugeve Dytësore dhe Lokale”.

Në këtë zë përfshihen të gjitha likujdimet e kryera në favor të kontraktorëve për projektimin e objekteve të reja si dhe për supervizionin e objekteve që janë në zbatim dhe në përfundim të punimeve.

## **Asistenca Teknike**

Ky komponent është realizuar në vlerën 776 mijë USD ose në masën 84 % kundrejt Buxhetit vjetor dhe përfshin konsulencë të huaj në kuadër të Projektit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale në vlerën 356 mijë USD, në kuadër të Projektit të Furnizimit me Ujë të Zonave Rurale – KfW rreth 363 mijë USD (rreth 100 mijë USD janë detyrime të vitit 2011 të paguara në Janar 2012), si dhe 57 mijë USD të financuara nga fondet tona që përfshin konsulencë inxhinierike.

## **Kualifikime**

Ky komponent përfshin shpenzimet e bëra për kualifikimin e stafit të FSHZH-së dhe të Komunave dhe Bashkive në përputhje me buxhetin e aprovuar. Ky zë është realizuar në vlerën 48 mijë USD ose në masën 20% kundrejt buxhetit vjetor. Në këtë kategori janë përfshirë shpenzimet për kualifikime me temë “Zhvillimi ekonomik lokal” dhe “Mirëmbajtja e Rrugëve” për stafet e komunave dhe bashkive si dhe aktivitete të stafit brenda dhe jashtë vendit. Për përmirësimin e menaxhimit dhe buxhetimit për mirëmbajtjen e rrugëve rurale janë planifikuar edhe rreth 101 mijë Euro të cilat do financohen nga BEI Grant për vitin 2012. Tenderi është shtyrë pasi po diskutohet me BERZH/BEI për konceptin e trajnimeve që do të përdoret për këtë fond.

## **Pajisje**

Kjo kategori është realizuar në vlerën 92 mijë USD ose në masën 100 % kundrejt buxhetit vjetor 2012. Në këtë zë janë përfshirë pagesat për sistemin e sigurisë së institucionit, për 2 mjete transporti dhe pajisje kompjuterike për institucionin si dhe investim në rrjetin elektrik për komunën Margegaj në kuadër të projektit të Punëve në Komunitet III.

## Shpenzime operative

Shpenzimet operative janë realizuar në vlerën 192 Milionë Lekë ose rreth 85 % kundrejt buxhetit vjetor 2012.

Realizimi i zërave të shpenzimeve të nën-komponentëve të kësaj kategorie kundrejt buxhetit vjetor janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

### Realizimi i shpenzimeve operative kundrejt buxhetit vjetor 2012.

#### Analiza e shpenzimeve të kostos operative

BUXHET 2012 (Kosto operacionale) Lekë				
No	ZERAT	BUXHET 2012	REALIZIMI VJETOR 2012	PERQINDJA E REALIZIMIT
1	Kanceleri	3,000,000	2,426,029	80.87
2	Karburant	10,850,000	10,215,083	94.15
3	Servis makinash/siguracion	7,550,000	5,272,858	69.84
4	Pagat	156,637,000	146,258,358	93.37
5	Dieta	9,600,000	5,828,581	60.71
6	Telefon dhe PT	5,250,000	5,246,335	99.93
7	Internet	750,000	672,121	89.62
8	Energji Elektrike/Uje	2,410,000	2,256,133	93.62
9	Zyra me qera	1,200,000	1,160,171	96.68
10	Mirembajtje/Sigurim godine	3,400,000	2,586,368	76.07
11	Te tjera/Petty cash	4,620,000	4,500,000	97.40
12	Publikimi & Promovime	23,000,000	3,851,408	16.75
13	Shpenzime gjyqesore	400,000	93,799	23.45
14	Kontrata Sherbimi	2,000,000	1,389,497	69.47
15	Servis kompjuter dhe fotokopje	750,000	716,020	95.47
	<b>TOTAL</b>	<b>231,417,000</b>	<b>192,472,761</b>	<b>85</b>

#### a. Shpenzimet për kancelari

Gjatë këtij viti shpenzimet për kancelari janë realizuar në vlerën prej 2.42 milione Lekë ose 80.87 % kundrejt buxhetit vjetor. Shpenzimet kryesore në këtë zë janë kryesisht për kancelari të ndryshme, letër, bojra për fotokopje dhe printera, etj.

#### b. Shpenzimet për karburant

Buxheti vjetor i parashikuar për këtë zë të shpenzimeve është 10.85 Milionë Lekë, ose 4.69 % të buxhetit vjetor të kostos operative. Gjatë këtij viti shpenzimi i kryer është në vlerën 10.21 Milionë Lekë, ose 94.15 % kundrejt buxhetit vjetor.

c. Shpenzimet për mirëmbajtjen dhe siguracion të automjeteve

Këto shpenzime përfshijnë shërbimet periodike, shërbimet e veçanta, blerjen e pjesëve të këmbimit, gomave dhe siguracionin e mjeteve. Buxheti i parashikuar për këtë zë është rreth 7.55 Milionë Lekë. Realizimi për këtë vit është rreth 5.27 milione Lekë ose 69.84 % kundrejt Buxhetit vjetor 2012. Realizimi në këto masa vjen si rezultat i dhenies së automjeteve në administrim të vetë inxhinierëve të FSHZH-se që punojnë kryesisht nëpër në rrethe, të cilët mbulojnë vetë shpenzimet e riparimit të mjeteve që përdorin.

d. Shpenzimet për paga, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore

Shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore për vitin 2012 janë parashikuar në shumën 156 Milionë Lekë. Ky zë është realizuar në masën 93.37 % kundrejt buxhetit vjetor të parashikuar.

e. Shpenzimet për dieta e shërbime

Shpenzimet për dieta dhe shërbimet për vitin 2012 janë parashikuar në shumën 9.6 Milionë Lekë. Ky zë shpenzimesh është realizuar në vlerën 5.82 Milionë Lekë ose 60.71 % kundrejt Buxhetit vjetor 2012. Ai mbështet kryesisht aktivitetin e kryer nga Departamenti i Infrastrukturës për mbikqyrjen e objekteve në terren. Ulja e shpenzimeve në masën 40% në këto vjeçe vjen si rezultat i reformës së ndermarre në trajtimin financiar të punonjësve që shkojnë me shërbim jashtë qendres së punës.

f. Shpenzimet e komunikimit

Në këtë zë përfshihen shpenzimet për komunikim si edhe shpenzimet e shërbimit postar. Ky zë është parashikuar 5.25 Milionë Lekë për vitin 2012 dhe është realizuar në vlerën 5.24 Milionë Lekë ose 99.93 % kundrejt Buxhetit vjetor.

g. Shpenzime të tjera

Në zërin shpenzime të tjera përfshihen shërbim interneti, facilitete rajonale të FSHZH-së, energji elektrike, ujë, servis kompjuteri dhe fotokopje, ruajtje e godinës, mirëmbajtje e sistemeve të zyrave qendrore, siguracione, seminare të stafit, blerje të vogla etj. Për këtë zë në buxhetin 2012 janë parashikuar rreth 13 Milionë Lekë nga të cilat 2.4 milione leke janë planifikuar të financohen nga fondet e veta. Ky zë është realizuar në vlerën 11.89 Milionë Lekë ose 90.56% kundrejt Buxhetit vjetor 2012.

h. Publikime & Promovime

Në këtë zë përfshihen shpenzimet për publikime të ndryshme në kuadër të promovimit të punës dhe imazhit të institucionit. Për këtë zë në buxhetin 2012 ishin parashikuar rreth 23 Milionë Lekë nga të cilat 22.2 milione leke financohen nga fondet e veta. Realizimi i këtij zeri është në vlerën 3.85 milion Lekë. Pjesa kryesore ishte parashikuar për realizimin e një spoti televiziv i cili për arsye procedurale është shtyrë për në fillim të vitit 2013.

### i.Kontrata shërbimi dhe shpenzime gjyqësore

Në këtë zë përfshihen shpenzime gjyqësore dhe asistencë juridike si dhe pagesa për kontrata shërbimi. Për këtë zë në buxhetin 2012 janë parashikuar rreth 2.4 Milionë Lekë dhe realizimi është në masën 1.48 milion leke ose në masën 61.80 % kundrejt Buxhetit vjetor.

## 3.2 Komunikimi dhe Informimi

Komunikimi dhe Informimi është një aspekt mjaft i rëndësishëm i punës së Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Arritjet e deritanishme të FSHZH-së, dhe veçanërisht intensiteti i lartë i projekteve dhe investimeve për këtë periudhë nëpërmjet një strategjie komunikimi të mirëpërcaktuar i janë komunikuar një publiku më të gjerë.

Gjatë vitit 2012, veçanërisht gjatë gjashtëmujorit të fundit, është organizuar një fushatë e gjerë informimi publik, në funksion të paraqitjes së rezultateve të arritura qoftë në volumin e madh të punimeve ashtu edhe në buxhetin e realizuar, si edhe në respekt të 100 vjetorit të pavaresisë së vendit.

Informimi i publikut është realizuar në këto drejtime:

- Mediat televizive

Aktiviteti i FSHZH ka qënë prezent në median vizive me një frekuece minimalisht prej 2 kronikash në javë me një total prej 45 kronikash të transmetuara e të mbuluara në nivel kombëtar me tre mediat kryesore kombëtare, në edicionet e lajmeve si edhe në rreth 10 televizione lokale me peshë. Gjithashtu është krijuar një rrjet i gjërë me gazetarë të televizioneve primare e ato sekondare. Televizionet të cilat kanë transmetuar aktivitetin e FSHZH janë : TVSH, Top Channel, Klan Tv, ABC News, Ora News, Albanian Screen, Utv, etj.

Një emision special për punën që kryen FSHZH është organizuar nga TV 1 Channel në qytetin e Shkodrës.

- Shtypi i shkruar

Përveç mbulimit televiziv të aktivitetit, paralelisht është bërë dhe pasqyrimi i aktivitetit të FSHZH-së në shtypin e shkruar. Cdo dalje në terren është pasqyruar dhe në të përditshmet kryesore në Shqipëri si: "Gazeta Shqip", Gazeta "Panorama", "Gazeta Shqiptare", "Standard", "Koha Jonë", "Gazeta 55", etj. Gjithashtu është kushtuar një vëmendje e veçantë nga media e shkruar punës së FSHZH-së. Disa artikuj të rubrikës "Speciale" me intervista, janë përgatitur në revista, gazeta, si dhe media elektronike si: Revista Monitor, ATSH, Gazeta Standard etj.

- Faqja zyrtare e web-it

I gjithë aktiviteti në kuadër të informimit të publikut është pasqyruar me detaje e imazhe në faqen zyrtare të web-it të FSHZH në gjuhën shqipe dhe atë angleze.

Gjithashtu ka vijuar publikimi në faqen e internetit i të gjitha lajmeve, njoftimeve dhe prokurimeve të cilat janë zhvilluar gjatë kësaj periudhe, si edhe ka pasur një ndërveprim aktiv në faqen e internetit për sa i përket aktiviteteve të zhvilluara në kuadër të Programit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale dhe programeve të tjera

- Aktivitete dhe evente informative

Gjatë kësaj periudhe krahas informimit publik që është realizuar nëpërmjet kronikave televizive në objekte, është kryer dhe një set fotografish profesionale në kuadër të

Programit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale, për arkivimin e fotove të projekteve të cilat kanë përfunduar së implementuari në të gjithë Shqipërinë. Ky set fotografish prej rreth 2000 copësh është dorëzuar pranë Njesisë së Komunikimit dhe Vlerësimit për t'u përdorur jo vetëm për materialet publicitare të prodhuara në kuadër të përmirësimit të imazhit të FSHZH-se por dhe për dokumentim të tyre.

Në fund të muajit Shtator 2012, FSHZH mori pjesë në Kongresin e Parë të Rrugëve i cili u organizua nga Shoqata Shqiptare e Inxhinierëve Konsulente. FSHZH ishte pjesëmarrës në këtë aktivitet si një ndër aktorët më të rëndësishëm në fushën e investimeve të infrastrukturës rrugore. Gjatë këtij eventi 2 ditor, pjesëmarrësit treguan interes të vecantë për punën e FSHZH-së në forumet e diskutimet e organizuara.

Gjithashtu gjate muajit Nentor FSHZH mori pjese ne Panairin e Librit 2012, ku nepermjet nje hapësire informuese u ekspozuan aktivitetet kryesore te FSHZH dhe u shperndane materiale te ndryshme informative.

Po gjatë këtij viti janë prodhuar nga kompania e perzgjedhur, materialet informative, si psh : Libërth për Rrugët Dytësore e Lokale në gjuhën shqipe dhe atë angleze, dosje apo materiale te loguara me imazhin e FSHZH etj. Këto aktivitete jane kryer në kuader të fondeve të dhena nga grant CEB përmes Norway Trust Account. Në kuadër të këtij granti janë organizuar pranë zyrave qendrore në Tirane dy takime informuese me punonjës të Njësive të Qeverisjes Vendore.

### **3.3 Monitorimi dhe Vlerësimi**

Gjatë periudhes Janar - Dhjetor 2012, ka vijuar puna për monitorimin e ecurisë së tre programeve kryesore në zbatim nga FSHZH.

Monitorimi i ecurisë së Programit të Rrugëve Dytësore & Lokale në të gjithë elementet e tij, ka qenë një ndër aktivitetet parësore të sektorit të Monitorim – Vlerësimit. Puna për monitorimin e programit ka konsistuar në marrjen dhe vlerësimin e të dhënave mbi ecurinë e nënprojekteve për të gjitha fazat e investimit dhe të gjithë Donatorët.

Janë shqyrtuar të gjitha raportet mujore periodike të hartuara nga supervizori Louis Berger SAS, dhe është bërë monitorimi i indikatorëve të ecurisë së projektit, duke përfshirë avancimin teknik dhe atë financiar.

Në kuadër të monitorimit të këtij programi, jane përgatitur raporte të monitorimit të programit, Me kërkesë të donatoreve që kanë financuar këtë program janë dërguar informacione që lidhen me ecurinë e programit dhe indikatorët e performancës.

Në fund të ketij viti, vërehet një performancë shumë e mirë e programit në të gjithë elementët e tij.

#### **Vlerësimi i impaktit te Programit të Rrugëve Dytësore & Lokale.**

Një tjetër aktivitet i rëndësishëm i sektorit të Monitorim – Vlerësimit, ka qenë organizimi i punës për studimin e vlerësimit të impaktit të këtij programi.

Ky vlerësim është mbështetur financiarisht nga Banka e Këshillit të Europës (CEB), në formën e grantit, permes Norway Trust Account.

Në këtë studim u anketuan rreth 2000 familje në të gjithë territorin e vendit, dhe 144 komunitete. Pjesë e këtij studimi ishte dhe ngritja e grupeve fokus, që mbylli ciklin e anketimit në terren.

Gjatë muajit Mars 2012 ka përfunduar puna në terren për plotësimin e 2000 pyetësorëve dhe baza e të dhënave, për ti lënë vend përpunimit të thelluar statistikor. Gjate kesaj periudhe ka vijuar puna per përpunimin statistikor dhe nxjerrjen e rezultateve te anketimit për fazën e parë (Base line). Rezultatet e këtij studimi u përmbledhen në një raport i cili jep informacion të detajuar për situatën social – ekonomike në zonat ku është kryer studimi në fazën e mbledhjes së të dhënave bazë.

Studimi ka një shtrirje kohore 3 vjecare. Ndërkohë në vitin 2013, është parashikuar finalizimi i vlerësimit, dhe hartimi raportit të vlerësimit të impaktit.

Vlerësimi i impaktit të Programit “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”, është një nga statet më të rëndësishme të tij, pasi do të studiojë dhe vlerësojë ndikimin që ka ushtruar programi në aspektet socio-ekonomike, por edhe mjedisore për përfituesit në zonat ku ai është implementuar.

**Programi Punët në Komunitet III.** Gjatë këtij viti është monitoruar nga afër zbatimi i projektit në të gjithë komponentët dhe elementët e tij.

Objekti i punës së monitorimit periodik kane qënë komponentët kryesorë të programit, financimi i nënprojekteve prioritare në infrastrukturë, ngritja e kapaciteteve dhe hartimi i planeve të zhvillimit lokal dhe sektorial.

Performanca e menaxhimit financiar, prokurimeve, zbatimit të punimeve civile, çështjeve të lidhura me mjedisin, janë monitoruar përmes shqyrtimit të informacioneve dhe dokumentacionit në tavolinë, si dhe kryerjes së vizitave në terren.

Si konkluzion i monitorimit të ecurisë së programit, vërehet se performanca e tij është shumë e mirë në të gjithë komponentët përbërës dhe ka plotësuar objektivat kryesorë të tij në përputhje me pritshmerinë e Donatorit.

Në kuadër të këtij programi, u krye Vlerësimi i Përfituesve, i cili anketoj në terren përfituesit e drejtpërdrejtë, në lidhje me çështje të ndryshme të zbatimit të programit dhe përfitimet social – ekonomike që kanë pasur banorët nga ky program. Gjatë periudhës Janar – Mars 2012, përfundoi metodologjia e vlerësimit dhe janë përgatitur pyetësorët. Gjate muajit Maj është kryer testimi i pyetësorëve për ti lënë vend anketimit të plotë në terren në komunitetet përfituese të këtij projekti. Puna ne terren per plotesimin e pyetesoreve ne terren filloi gjate muajit Qershor dhe perfundoi gjate muajit Korrik 2012. Hedhja e të dhënave në data – base dhe përpunimi statistikor u kryen gjate periudhes Gusht – Shtator 2012. Rezultatet e këtij anketimi do të përfshihen në raportin e vlerësimit të përfituesve i cili është duke u hartuar.

**Monitorimi i Programit “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale”** ka ndjekur treguesit periodikë të komponenteve kryesorë të tij duke i krahasuar me planet e punës, dhe ka vërejtur përgjithësisht një ecuri të mirë të këtij programi. Gjatë kësaj periudhe puna është fokusuar në monitorimin e indikatorëve bazë të programit, deri në këtë fazë të zbatimit të tij. Pas fillimit të punimeve civile në terren, janë shqyrtuar me kujdes raportet e supervisorëve për të gjitha skemat e financuara dhe konstatohet se faza e zbatimit të punimeve civile paraqet performancë pozitive.

## **Përditësimi i databazës së nënprojekteve të zbatuara nga FSHZH 1993 – 2012, dhe përgatitja e informacioneve të ndryshme.**

Një aktivitet i rëndësishëm për sektorin e monitorimit ka qenë përditësimi dhe përmirësimi i databazës së nënprojekteve të infrastrukturës të financuara nga FSHZH gjatë periudhës 1993 – 2012. Është punuar në mënyrë periodike për përditësimin e të dhënave të programeve në zbatim. Njëkohësisht është punuar për popullimin me të dhëna bazë të disa nënprojekteve të viteve të kaluara, duke bërë verifikimet dhe plotësimet e nevojshme. Sektori i Monitorim-Vlerësimit, gjatë kësaj periudhe ka përgatitur një sërë informacionesh të ndryshme mbi ecurinë e programeve me kërkesën e donatorëve apo institucioneve të interesuara.

### **3.4 Auditimi i brendshëm**

Njesia e Auditit të Brendshëm, gjatë vitit 2012, ka kryer aktivitetin bazuar në planin vjetor të auditimit, dhe ka realizuar 8 misione auditimi, ndër të cilët 7 misione të planifikuara dhe 1 (një) auditim ad-hoc me kërkesë të Drejtorit Ekzekutiv, si dhe raporte mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Janë audituar të dy programet në proces implementimi; Programi i Përmirësimit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale; Programi i Furnizimit me Ujë i Zonave Rurale.

Janë përfshirë në proces auditimi 49.7 milion dollarë fonde të implementura, ku janë bërë vlerësimet e kontrollet teknike e financiare për 26 nënprojekte dhe janë kontrolluar në terren 258.65 km rrugë. Gjithashtu, janë bërë vlerësimet tekniko financiar si dhe kontrolli në terren për 6 skema ujeshjellsash, ku janë përfshirë 29 fshatra

Nga misionet e ushtruara është konstatuar se:

- Fondi Shqiptar i Zhvillimit gjatë vitit të vitit 2012 ka siguruar performancë të mirë në implementimin e fondeve dhe ka rritur efikasitetin e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm të projekt/programeve. Sistemi i ngritur siguron monitorim të plotë të programeve, konstatimin e dobësive dhe mangësive dhe jep mundësinë e korrigjimit të shpejtë të tyre gjatë fazës së zbatimit.
- Funkcionon një bashkëpunim i vazhdueshëm institucional ndërmjet aktoreve të përfshirë në proces: FSHZH; donatoreve; supervizorit; kontraktorit; njësive të qeverisjes vendore, etj.
- Fondi ka konsoliduar një sistem të raportimit, informimit dhe komunikimit i cili garanton nxjerrjen e raportimeve të shpejta dhe të sakta dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara të donatoreve, qeverisë shqiptareve apo grupeve të interesit.

Përveç sa më sipër, në misionet e auditimit janë konstatuar mangësi apo pamjaftueshmëri të sistemit të menaxhimit e kontrollit të brendshëm në disa pjesë të veçanta të tij. Në analizën e gjetjeve, njësia ka vlerësuar riskun dhe impaktet e tyre në arritjen e objektivave; Kështu, është konstatuar se:

- Në fazën e projektimit konstatohen projekte teknike që nuk janë në përputhje me standartet programit, të kontratave FIDIC apo zgjidhje teknike joefektive. Është vlerësuar me risk të konsiderueshëm tërheqja e projekteve nga NJQV apo ARrSh.
- Me daljen e ligjit të ri “Për planifikimin e territorit” vlerësohet një risk i moderuar që lidhet me vonesat në nxjerrjen e lejeve të ndërtimit për nënprojektet e reja.



- Konstatohen probleme sociale, apo te pronësisë mbi token, te pidentifikuara apo zgjidhura ne fazat fillestare, te cilat sjellin vonesa ne zbatimin e punimeve apo ndryshime ne projektin teknik.
- Ne fazën e zbatimit teknik te projekteve konstatohen raste te punimeve me cilësi te dobët, vonesave ose zvarritje ne grafiket e punimeve ne terren te cilat shkaktohen nga mangësitë ne projekt, nga problemet sociale apo kontrakte te cilët nuk performojne mire. Auditit konstaton se NjIRr është e mirinformuar për situata te tilla dhe ne bashkëpunim me supervizorin e projektit janë te angazhuar ne menaxhimin e kontratave te punimeve.
- Lidhur me Programin e Ujesjellsave Rural (PUR) konstatohet ecuri e mire ne ndërtimin e skema te ujesjellsave por vlerësohet si risk i konsiderueshëm garantimi i dy indikatorëve te programit: licencim/tarifim dhe mirëmbajtja e sistemeve te ujesjellsave te ndërtuar.

Për të gjitha mangësitë dhe gjetjet e auditimit, gjate vitit janë dhënë 57 rekomandime, qe kryesisht lidhen me përmirësimin e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm teknik e financiar, dhe ndjekjen e afateve e cilësisë e punimeve të ndërtimit. Të gjitha raportet e auditimit janë aprovuar nga Drejtori Ekzekutiv dhe janë mbështetur me urdhra te brendshëm qe garantojnë zbatimin e rekomandimeve për secilin auditim.

Gjate vitit janë realizuar 5 raporte auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve ne te cilat është konstatuar impenjim i plote i strukturave për korrigjimin e mangësive te konstatuara dhe konsolidimin e sistemit te kontrollit te brendshëm. Është konstatuar se nga rekomandimet te dhëna, 35 janë realizuar 22 janë ne proces realizimi.

#### **4. AKTIVITETE TE TJERA**

##### **4.1 Misione të Donatorëve**

- Mision i Bankës së Këshillit të Europës për Zhvillim (CEB), në kuadër të Projekteve “Punët në Komunitet III” dhe “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”

Dy misione të Bankës së Këshillit të Europës për Zhvillim (CEB) vizituan Shqipërinë në muaj Shkurt dhe Mars 2012, për të kryer vlerësimin e ecurisë së Projekteve “Punët në Komunitet III” dhe “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”. Objektivat kryesore të dy misioneve ishin:

- (i) Progresi i menaxhimi i projektit dhe supervizimi;
- (ii) Cështje të qëndrueshmërisë së projekteve;
- (iii) Impakti mjedisor dhe social – ekonomik;

Të dy misionet konstatuan një ecuri të kënaqshme të projekteve si edhe përputhshmëri në lidhje me planin e punës.

- Mision i Bankes Islamike per Zhvillim në kuadër të Projektit “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale

Nje mision i Bankes Islamike per Zhvillim, vizitoi Shqiperine ne muajin Tetor 2012, per te vleresuar projektin “Përmirësimi i rrugëve dytësore dhe lokale”. Objektivi kryesor i këtij misioni ishte supervizimi vlerësimi i progresit te projektit per pjesen e financuar me fonde te IDB. Misioni vlerësoi nje ecuri mjaft te kënaqshme te projektit si ne aspektin e menaxhimit ashtu edhe ne ate te zbatimit te tij.

- Mision i Fondit OPEC per Zhvillimi Nderkombetar  
Nje mision i OFID i kryesuar nga Drejtori i Pergjithshem i tij, zhvilloi nje vizite pune ne Shqiperi gjate muajit Tetor 2012. Objektivi i ketij misioni ishte vleresimi i progresit te projektit "Permiresimi i Rrugeve Dytësore dhe Lokale".

Misioni ne fjale vleresoi mjaft pozitivisht progresin e bere nga projekti dhe duke theksuar se jane realizuar me se mire objektivat per te cilat ai eshte financuar.

#### 4.2 Ndërtimi i kapaciteteve të NjQV-ve

**Qendra Burimore e Zhvillimit Rajonal dhe Lokal**, e cila ofroi aktivitetet e para trajnuese në fund të vitit 2011, përbën komponentin më të rëndësishëm të punës së Departamentit të Zhvillimit Rajonal për periudhën Janar - Dhjetor 2012. Synimi është që çdo muaj qendra të ofrojë aktivitete trajnuese dhe kualifikuese me tema të ndryshme, qoftë duke ripërpunuar modulet e trajnimit që kemi ofruar deri tani, qoftë duke krijuar module të reja. Produkti në fund të vitit është një kalendar i pasur trajnimesh dhe ofrim asistence për administratën publike në nivel lokal.

Gjatë muajit Janar, Qendra e Trajnimeve ofroi 2 seri trajnimesh me temë "Përgatitja e projekteve të sukseshme për financimin e infrastrukturës vendore". Trajnimet dy ditore u ofruan në datat 17-18 dhe 23-24 Janar. Në total morrën pjesë 50 pjesëmarrës.

Gjatë muajit Shkurt dhe Mars Qendra ofroi trajnimin me temë "Mirëmbajtja e Rrugëve Rurale" – një trajnim i ofruar për stafin e Njësive vendore të Qarkut Tiranë dhe Durrës. Ky trajnim u ofrua në kuadër të projektit "Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale në Shqipëri". Trajnimi gërshetoi sesione në klasë dhe vajtje në terren për të demonstruar aplikimin e njohurive që u dhanë në pjesën e parë.

Muaji Mars shënoi fillimin e konsulencës për përgatitjen e një koncepti strategjik për qendrën e trajnimeve. Përgatitja e Termave të referencës për dy konsulente lokale ishte hapi i parë. Për të asistuar konsulentët u krijua një grup i vogël me persona kyç në FSHZH. Disa takime u organizuan për të diskutuar mbi çështje që lidhen me krijimin dhe funksionimin e qendrës. Muaji Qershor shënoi finalizimin e dokumentit strategjik, i cili do të orientoje punën e Qendres së Trajnimeve ne te ardhmen.

Muaji Prill dhe Qershor ofruan për administratën lokale dy cikle të kursit tre ditor të trajnimit me temë "Planifikimi Strategjik me Pjesëmarrje" gjatë datave 17-19 Prill dhe 19-21 Qershor. Zhvillimi i këtij trajnimi lidhet ngushtë me përvojën e pasur të FSHZH-së ndër vite në hartimin e planeve strategjike vendore. Trajnimi i aftësoi pjesëmarrësit të jenë lider të procesit të planifikimit të zhvillimit lokal përmes paraqitjes së metodologjisë "10 Hapat drejt Suksesit" ndjekur nga FSHZH.

Një tjetër aktivitet trajnues që diversifikon axhendën e Qendrës së Trajnimit është edhe kursi tre ditor i trajnimit me temë "Gjenerimi dhe Menaxhimi i Projekteve në Nivel Vendor dhe Rajonal". Ky kurs trajnimi u ofrua në dy sesione, gjatë datave 29-31 Maj dhe 25-27 Qershor. Zhvillimi i këtij trajnimi u lidh ngushtë me përvojën e pasur të FSHZH-së ndër vite në identifikimin, planifikimin, formulimin dhe zbatimin e një serie projektesh për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social në nivel vendor dhe rajonal. Ky kurs trajnimi synoi rritjen e nivelit të të kuptuarit dhe aftësive praktike mbi gjenerimin e

projekteve dhe menaxhimin e tyre në nivel vendor dhe rajonal. 28 pjesëmarrës nga të gjitha njësitë e qeverisjes vendore në Shqipëri u certifikuan në fund të sesioneve.

Muaji tetor solli në fokus trajtimin mbi ndikimin që projektet infrastrukturore të të gjitha tipeve kanë në mjedis. Njësia e Mjedisit pranë FSHZH, përgatiti një trajnim praktik rreth këtyre çështjeve kritike mjedisore duke i adresuar në kursin e trajnimit me temë "Aspektet mjedisore gjatë planifikimit dhe zbatimit të projekteve infrastrukturore". Trajnimi ishte dy ditor dhe u zhvilluar 23-24 tetor, 2012. Trajnimi u fokusua në trajtimin e çështjeve më kritike mjedisore që stafi menaxherial dhe ai teknik i njësive vendore në mbarë vendin përballet në punën e tyre gjatë planifikimit dhe zbatimit të projekteve infrastrukturore. Çështje të tilla, si legjislacioni, procedurat për lejen mjedisore, plani i menaxhimit të mjedisit, të trafikut, sinjalistika dhe çështje të tjera specifike të zbatimit u trajtuan me detaje në këtë kurs dy ditor.

Gjatë gjysmës së dytë të muajit nëntor 2012 u ofruan katër sesione të kursit të trajnimit njëditor "Mirëmbajtja e Rrugëve Rurale". Sesionet u ofruan në datat 15, 16, 20 dhe 21 Nëntor. Ky kurs trajnimi ofrohet në kuadër të projektit "Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale në Shqipëri" dhe sesionet ofrohen për pjesëmarrësit në bazë Qarku. Kursi përfshin gërshetimin e sesioneve në klasë dhe vizitë në terren për të demonstruar aplikimin e njohurive që jepen në pjesën e parë të sesionit.

Aktivitet tjetër i rëndësishëm i Dep. Zhvillimit Rajonal lidhet me zhvillimin e aktivitetit promovues, në bashkëpunim me komunën Kelmend, me temë "Koordinimi i Ndërhyrjeve për Zhvillimin Vendor në Komunën Kelmend". Aktiviteti u organizua më 28 Qershor në komunën Kelmend. Qëllimi kryesor i aktivitetit lidhet me diskutimin mbi mundësitë e zhvillimit të zonës, nxitjen dhe koordinimin e ndërhyrjeve publike, por edhe promovimin e zonës së Kelmendit, vlerave natyrore dhe kulturore që mbart. Fokusi i takimit u përqëndrua në bashkërendimin e veprimeve nga aktorët vendas dhe ndërkombëtarë për krijimin e sinergjive pozitive dhe koordinimin e përpjekjeve në funksion të zhvillimit vendor në Kelmend. Në këtë aktivitet morrën pjesë përfaqësues të Qarkut dhe Prefekturës Shkodër, komunave të tjera të Malësisë së Madhe, përfaqësues të organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare si MADA (Agjensia e Zhvillimit të Zonave Malore), GIZ (Agjensia Gjermane për Zhvillim), ADC (Agjensia Austriake për Zhvillim), VIS Albania, Ministria e Integritetit si edhe përfaqësues të shoqërisë civile vendore.

Aktivitet i ri i identifikuar në tremujorin e parë të vitit është edhe ofrimi i mëtejshëm i *asistencës teknike Ndërkomunales së Zadrimes* dhe pesë njësive vendore anëtare të saj (Komunat Bushat, Blinisht, Hajmel, Dajç dhe Bashkia Vau i Dejës). Qëllimi i kësaj asistence ka të bëjë me operacionalizimin e Strategjisë së Zhvillimit Ndërkomunal të Rajonit Zadrime. Kjo strategji u hartua nga Ndërkomunalja e Zadrimes dhe Njësitë Vendore anëtare të saj me asistencën teknike të Fondit Shqiptar të Zhvillimit gjatë periudhës Shtator 2010-Prill 2011. Ekipi i punës gjatë periudhës Mars-Qershor 2012 është marrë me organizimin e takimeve të para me qëllim finalizimin e planit të punës.

Njëkohësisht specialistët e Departamentit të Zhvillimit Rajonal kanë marrë pjesë në disa evente (takime, konferenca, seminare, tryeza të rrumbullakëta) të organizuara nga aktorë të tjerë. Ajo që vlen të theksohet në këtë është pjesëmarrja në konferencën kombëtare "Qeverisje vendore e fortë dhe efektive nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit drejt qeverisjes së mirë". FSHZH në bashkëpunim me Programin për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp) prezantuan *Mundësitë e Planifikimit dhe financimit ndërvendor në*

*Shqipëri* - rasti i planifikimit strategjik të rajonit Zadrimë, si një nga nismat e pakta të planifikimit strategjik ndërvendor.

### 4.3 Përgatitje e projekteve për financim

Gjatë këtij viti FSHZH është angazhuar në përgatitjen e projekteve të reja për tu aplikuar pranë donatorëve të ndryshëm për financim.

Gjatë vitit 2011 është përgatitur projekti dhe dokumentacioni për aplikim pranë **WBIF** (Western Balkan Investment Framework) për një financim grant në vlerën prej rreth 1 milion Euro për përgatitjen e një strategjie zhvillimi dhe përgatitja e një projekti për një kredi të mëvonshme nga CEB për zhvillimin e zonës së Alpeve. Këtu do të përfshihet master-plani i zhvillimit të zonës, strategjitë lokale të komunave e hartimi i planeve hapësinore për disa nga qendrat kryesore të Alpeve, përgatitja e projektit “Punët me Komunitet IV” për tu mbështetur nga CEB dhe projektet konkrete teknike për zonat ku do të ndërhyhet në bazë të planit të zhvillimit të infrastrukturës lokale e rajonale. Projekti është aplikuar në raundin e 6-të të Bordit të WBIF (në mbledhjet në Shtator e Nëntor 2011) dhe ka marrë përgjigje pozitive.

Përgatitja e fishave të aplikimit për thithjen e financimeve nga fondet e Instrumentit të Paraaderimit (IPA) ka qene nje tjetër angazhim i FSHZH.

Projekt fisha e pare e përgatitur ne këtë skemë financimi, ndryshe IPA 2012, ka të bëjë me përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike ndaj grupeve vulnerabël në zonat periferike të Tiranës dhe Durrësit. Bazuar ne këtë, projekti i propozuar synon të përmirësojë situatën në dy zonat periferike në Njësitë Administrative Nr.4 dhe Nr.8 në Tiranë dhe në Zonën e ish Kënetës Durrës. Projekti i përgatitur propozon një ndërhyrje integrale, duke përfshirë edhe ndërhyrjet respektive në infrastrukturën publike lokale.

